VENDIM
Nr.349, datë 4.5.2011

PËR KALIMIN E ISH-OBJEKTEVE TË USHTRISË, ISH-DEPO KAZERMIMI DHE ISH-NDËRMARRJA E NDËRTIMEVE USHTARAKE, TIRANË, NGA MINISTRIA E MBROJTJES NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR PRIVATIZIM NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10, 11 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, të ligjit nr.9321, datë 25.11.2004 "Për privatizimin e banesave dhe objekteve, të kthyera në banesa me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore", dhe të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", të ndryshuar", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e ish-objekteve të ushtrisë (ish-depo kazermimi nr.11, 14, 16, 17, 9, 12, 10, si dhe të ish-objekteve të Ndërmarrjes së Ndërtimeve Ushtarake nr.1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11), blloku nr.4, zona kadastrale 8120, Tiranë, nga Ministria e Mbrojtjes në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave, sipas formularit dhe planimetrive bashkëlidhur, me qëllim privatizimin në favor të banorëve të pastrehë, të cilët banojnë në këtë godinë, sipas listës bashkëlidhur.
2. Pas kalimit në përgjegjësi administrimi të Entit Kombëtar të Banesave, ngarkohet Enti Kombëtar i Banesave të lidhë kontratat e privatizimit me banorët e pastrehë, të përfshirë në listën sipas pikës 1 të këtij vendimi, sipas kushteve të privatizimit, të përcaktuara me udhëzim të veçantë të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit.
3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Enti Kombëtar i Banesave dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha